

REPUBLIKA E KOSOVES			
KOMUNA GLOGOC			
GLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	15/04/2026		
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-400	01-133	73	



Republika e Kosovës
Komuna Drenas
Zyra e Kryetarit



Komuna e Drenasit, në kuadër të zhvillimit të bujqësisë, bazuar në nenin 19 , pika 1.3 të Rregullores Nr.12-320-19338 të dt. 07.04.2017 për kushtet , kriteret dhe procedurat e ndarjës së subvencioneve, Rregullores për ndryshim dhe plotësim të rregullorës për ndarjën e subvencioneve me Nr.02-400/01-18380 të dt. 27.04.2022, nr 02-400/01-19798 të dt.29.05.2025 si dhe Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Islamic Relief Worldwide- Zyra në Kosovë dhe Komuna e Drenasit me Nr. 01-400/01-12595 të dt 08.04.2026, njofton të gjithë fermerët e interesuar që të aplikojn për projektet e poshtëshënuara:

THIRRJE PËR APLIKIM

1. Furnizim me Mbjellëse Gruri

2. Furnizim me Mbjellëse Misëri

3. Furnizim me Freza

➤ Kriterët që duhët plotësuar për aplikim:

1. Fermeri duhët të jetë banorë i Komunës së Drenasit;
2. Të posedoj tokë të punueshme:
 - Nëse aplikon për **Mbjellëse të Grurit** duhët të ketë së paku **5ha** të mbjellur me kultura bujqësore dy vitet e fundit (kjo dëshmohet me plotësim të aplikacionit nga aplikuesi dhe vertetohet me raportet që i posedon drejtorja nga aplikimet për Pagesa Direkte nga vitet 2024 dhe 2025);
 - Nëse aplikon për **Mbjellëse të Misrit dhe Frezë** duhët të ketë së paku **3ha** të mbjellur me kultura bujqësore dy vitet e fundit, përjashtimisht nëse fermeri ka të mbjellur perime duhet të ketë së paku 0.20h ne sere ose fushë të hapur, (kjo dëshmohet me plotësim të aplikacionit nga aplikuesi dhe vertetohet me raportet që i posedon drejtorja nga aplikimet për Pagesa Direkte nga vitet 2024 dhe 2025);
3. Të posedoj traktor (traktori duhet të ketë fuqi që i përgjigjet pajisjes për të cilën aplikon);
4. Të jetë i gatshëm për participim prej 30% të vlerës së asetit që përfiton;
5. Në bazë të rregullorës Nr.12-320-19338 të dt. 07.04.2017 neni 19, pika 2, rregullorës për ndryshim dhe plotësim për ndarjën e subvencioneve me nr. 02-400/01-18380 të dt.27.04.2022, neni 17, rregullore për plotësim ndryshimin e rregullorës për ndarjën e subvencioneve me nr 02-400/01-19798 të dt.29.05.2025 neni 8 - Përparësi në kushte të barabarta kanë:
 - ❖ Fermerët që nuk janë përfitues në vitin e fundit nga DBZHR-ja;

- ❖ Fermerët që nuk janë përfitues nga MBPZHR-ja dhe Donatorë të tjerë brenda vitit fiskal;
- ❖ Të rinjtë;
- ❖ Gjinia femrore;
- ❖ Familjet që kanë persona me nevoja të veçanta, familjet e dëshmorëve, familjet që kanë persona të zhdukur gjatë luftës, invalidët e luftës, veteranët e luftës, viktimat civile të luftës, familjet që kanë jetima, familjet e marginalizuara;
- ❖ Përsnat me gjëndje të rënd ekonomike;
- ❖ Fermerët të cilët jetojnë në zona malore;

➤ **Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

1. Aplikacioni i plotësuar;
2. Kopja e letërnjoftimit të aplikuesit;
3. Deklaratë për participim nga fermeri;
4. Librezën e regjistrimit të traktorit (nese posedon) ose foton e traktorit që e posedon si dhe foton e numrit të motorit (traktori duhet të ketë fuqi që i përgjigjet pajisjes për të cilën aplikon)
5. Dëshmi që posedon për përparsitë të cituara në piken nr.5 të thirrjes publike.

Sqarim: Kompletimi i dokumentacionit të kërkuar sipas thirrjes nga komisioni vlerësohet me 40%, ndërsa tereni vlerësohet deri me 60%.

Verejtje:

- Aplikacionet e paplotësuara dhe të pa kompletuara nuk merren në shqyrtim.
- Fermerët kanë të drejtë aplikimi vetëm në njerën nga projektet e lartëcekura përndryshe sanksionohen nga e drejta e përfitimit.
- Përfitues nuk mund të jetë ai që është në marrdhënje pune më institucionin që bënë përkrahjen.

Afati i aplikimit nga data 15.04.2026-06.05.2026.

Drenas 2026



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci